Banka e Shqipërisë

Departamenti i Politikës Monetare

Rezultatet e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues për Tremujorin e Tretë, 2014

Tetor 2014[1]

Standardet e kredisë mbetën të pandryshuara për *bizneset* dhe u lehtësuan për *individët* në tremujorin e tretë të vitit, bazuar në informacionin e marrë nga vrojtimi i aktivitetit kreditues. Pasi e lehtësuan pak në tremujorin e dytë, standardet e kredisë për *biznese* mbetën të pandryshuara, si për kredinë e dhënë për *kapital qarkullues* ashtu edhe për kredinë për qëllim të financimit të *investimeve*. Për kredinë dhënë *individëve*, bankat vijuan prirjen lehtësuese të standardeve për të katërtin tremujor rresht. Standardet u lehtësuan për të dy llojet e kredisë: për *blerje banese* dhe për kredinë *konsumatore*.

Lehtësimi i standardeve u ndikua nga **faktorë** që lidhen me gjendjen e *likuiditetit* të vetë bankave, nivelin e *konkurrencës* në sistemin bankar dhe politikat e ndjekura nga *Banka e Shqipërisë*. Disa nga faktorët kryesorë që dhanë ndikim për shtrëngimin e standardeve janë g*jendja financiare* e individëve dhe bizneseve, *kreditë me probleme* dhe zhvillimet në *tregun e pasurive të paluajtshme*.

Kushtet e vendosura nga bankat në momentin që miratojnë një kredi të re u përmirësuan, kryesisht në terma të uljes së *marzhit mesatar* për të dy llojet e klientëve, biznese dhe individë. Për bizneset, rritja e kërkesës për *kolateral* në tremujorin e tretë u përdor për të zbatuar një politikë më konservatore. Në përgjithësi, kushtet e vendosura nga bankat për individët u përmirësuan në tremujorin e tretë.

Kërkesa për kredi është vlerësuar në rritje, si për bizneset ashtu dhe për individët. Ndonëse përqindja neto e bankave që shprehen për rritje të kërkesës nga bizneset është pozitive, ajo është në rënie në krahasim me tremujorin e kaluar. Për individët konfirmohet një situatë më optimiste se sa për bizneset.

Pritjet e bankave janë më pak optimiste se sa vlerësimi për situatën korrente. Standardet e kredidhënies nuk pritet të lehtësohen në tremujorin e katërt, megjithëse bankat presin rritje të kërkesës, si nga bizneset ashtu edhe nga individët në tremujorin e katërt të vitit.

---

[1] Vrojtimi i realizuar në muajin shtator 2014 mbulon zhvillimet në aktivitetin kreditues të tremujorit të tretë të vitit 2014, si dhe pritjet e bankave për aktivitetin kreditues gjatë tremujorit të katërt të vitit 2014.

Kredia për bizneset

Standardet e Kredisë. Standardet e kredisë dhënë bizneseve në përgjithësi nuk u ndryshuan nga bankat në tremujorin e tretë të vitit 2014. Përqindja neto e përgjigjeve që shprehen për lehtësim shënoi 0% për kredinë dhënë *korporatave të mëdha,* si dhe për kredinë sipas *qëllimit* (për kapital qarkullues apo për investime). Balanca neto e standardeve shënoi një ndryshim të vogël pozitiv vetëm për kategorinë e *ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme*. Niveli i kësaj balance regjistroi +5% (neto), në rënie me 14.9 pikë përqindje nga tremujori i dytë. Bankat presin t'i mbajnë të pandryshuara standardet e kredisë për biznese edhe në tremujorin e katërt.

Grafik 1. Ndryshimet në standardet e zbatuara në kreditë për bizneset në total, sipas madhësisë së ndërmarrjeve dhe qëllimit të përdorimit të kredisë *(balanca neto[1], përqindja neto e bankave që kanë lehtësuar standardet)*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim 1. Balanca pozitive tregon për lehtësim të standardeve, ndërsa balanca negative tregon për shtrëngim të standardeve.

Faktorët me kontributin kryesor në lehtësimin e standardeve gjatë tremujorit të tretë të vitit kanë qenë niveli i *konkurrencës* në sistemin bankar dhe *politika lehtësuese e ndjekur nga Banka e Shqipërisë.* Në të njëjtin drejtim ka ndikuar edhe niveli *likuiditetit,* si dhe mjaftueshmëria e *kapitalit* të vetë bankave. Nga ana tjetër, e*curia e kredive me probleme, problemet specifike të sektorit* ku zhvillon aktivitetin e tij biznesi dhe *situata makroekonomike në vend* kanë vijuar edhe gjatë këtij tremujori të ndikojnë në kahun shtrëngues të standardeve të kredidhënies për bizneset, megjithëse në një shkallë rënëse nga tremujori në tremujor (grafiku 2).

Grafik 2. Ndikimi i faktorëve të ndryshëm në standardet e kredisë për bizneset *(balanca neto[2])*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim 2. Balanca pozitive tregon që faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve të kredidhënies; balanca negative tregon që faktori ka ndikuar në shtrëngimin e standardeve të kredidhënies.

Termat dhe kushtet me të cilat bankat zbatojnë ndryshimin e standardeve të kredidhënies kanë pasur zhvillime në kahe të ndryshme në tremujorin e tretë. *Ulja e marzhit mesatar, ulja e komisioneve dhe e kërkesës për kolateral në raport me madhësinë e huasë* kanë ndikuar në zbatimin e një politike lehtësuese në kredidhënie. Në të kundërt, rritja e *marzhit për kreditë me rrezik* dhe ulja e *madhësisë së kredisë* kanë ndikuar në zbatimin e një politike shtrënguese të kreditimit për tremujorin e tretë të vitit.

Grafik 3. Ndryshimi i kushteve për miratimin e kredive të bizneseve *(balanca neto[2], përqindje neto e bankave që janë shprehur për lehtësim të kushteve)*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim 2. Balanca pozitive tregon lehtësim të kushteve, ndërsa balanca negative tregon shtrëngim të kushteve.

Kërkesa për kredi. Në tremujorin e tretë të vitit 2014 bankat shprehen për rritje të kërkesës për kredi, por balanca neto e përgjigjeve ka rënë në krahasim me tremujorin e kaluar. Përqindja neto e bankave të cilat kanë perceptuar rritje të kërkesës shënon vlerën 2.9%, nga 11.7% që ishte në tremujorin e kaluar. Në ngadalësimin e kërkesës së bizneseve ndikoi rënia e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Për sa i përket qëllimit të përdorimit, balanca neto mbetet pozitive por në rënie, si për qëllime investimi ashtu edhe për financimin e kapitalit qarkullues.

Grafik 4. Ecuria e kërkesës së bizneseve për kredi sipas madhësisë së biznesit dhe qëllimit të përdorimit të kredisë *(balanca neto, përqindje neto e bankave që janë shprehur për rritje të kërkesës)*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Faktorët kryesorë në nxitjen e kërkesës për kredi në tremujorin e tretë të vitit 2014 kanë qenë *kushtet e kreditimit të aplikuara nga bankat* dhe nevoja për *financimin e inventarëve dhe të kapitalit* qarkullues. *Situata makroekonomike* në vend ka ndikuar pozitivisht në nxitjen e kërkesës për kredi, për të dytin tremujor rresht. Politika lehtësuese e *Bankës së Shqipërisë, nevoja për financimin e investimeve, si dhe burimet alternative të financimit* kanë ndikuar gjithashtu pozitivisht, por në një shkallë më të ulët, në rritjen e kërkesës.

Grafik 5. Faktorët ndikues në kërkesën për kredi të bizneseve (*balanca neto*[4])



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim 4. Balanca pozitive tregon rritje të kërkesës ose që faktori ka ndikuar në rritjen e kërkesës, ndërsa balanca negative tregon ulje të kërkesës ose që faktori ka ndikuar në uljen e kërkesës për kredi.

Kredia për individë

Standardet e kredisë. Rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues në tremujorin e tretë të vitit 2014 konfirmojnë lehtësimin e standardeve për kredinë dhënë individëve, në të dyja kategoritë e saj. Përqindja neto e bankave që shprehen për lehtësim të standardeve rezultoi +18.2%, nga rreth 16.9 % që ishte në tremujorin e dytë. Lehtësimi i standardeve të kredisë për individët është në linjë me pritjet e shprehura nga bankat në tremujorin e dytë të vitit. Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, standardet u lehtësuan, si për k*redinë konsumatore* ashtu dhe për atë me qëllim *financimin e blerjes së banesës*. Balancat përkatëse shënuan vlerat 17.9% dhe 27.8%, nga 15.5% dhe 22.5% në tremujorin e mëparshëm. Ekspertët e bankave presin lehtësim të standardeve të kreditimit për individët përgjatë tremujorit të katërt të vitit 2014, por në një masë më të vogël, si për standardet për *blerje banese* ashtu dhe për *financim të konsumit*.

Grafik 6. Standardet e kredisë për individët *(balanca neto)*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Faktorët kryesorë që kontribuuan në kahun lehtësues të standardeve të kredidhënies për individë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014, ishin: *niveli i konkurrencës në sistemin bankar* dhe *vendimet e Bankës së Shqipërisë. Gjendja e likuiditetit* dhe *zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme* ndikuan pozitivisht në lehtësimin e standardeve, por në një shkallë më të ulët. Nga ana tjetër, faktorët që dhanë kontribut në kahun shtrëngues të standardeve të kredisë dhënë individëve vijojnë të mbeten edhe gjatë këtij tremujori: *gjendja financiare e individëve, niveli i huave me probleme* dhe *mjaftueshmëria e kapitalit të bankës*. Krahasuar me tremujorin e kaluar, kontributi i këtyre faktorëve ka rezultuar më i ulët në tremujorin e tretë.

Grafik 7. Faktorët ndikues në standardet e kredisë për individët *(balanca neto)*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lidhur me **kushtet dhe termat** me të cilat jepet kredia, politika lehtësuese e standardeve të kredisë dhënë individëve u zbatua kryesisht nëpërmjet ngushtimit të *marzhit mesatar të kredive*, rritjes së *madhësisë së huasë*, si dhe uljes së raportit *të këstit me të ardhurat*. Zgjatja e *maturitetit maksimal të kredisë*, *ulja e komisioneve* dhe *ngushtimi i marzhit për kreditë me rrezik*, janë kushte që kanë kontribuar pozitivisht në lehtësimin e standardeve të individëve gjatë tremujorit të tretë të vitit, por në një shkallë më të ulët. Nga ana tjetër, rritja e *kërkesës për kolateral* ka vijuar të kontribuojë në zbatimin e një politike shtrënguese të kreditimit.

Grafik 8. Kushtet e aplikuara në miratimin e kredisë për individët (*balanca neto*)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kërkesa për kredi. Kërkesa e individëve për kredi vijoi të vlerësohet në rritje nga bankat, përgjatë tremujorit të tretë të vitit 2014. Balanca neto e përgjigjeve që raportojnë rritje shënoi vlerën 10.5%. Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, bankat raportojnë kërkesë në rritje për kredinë *konsumatore*. Nga ana tjetër, ndryshe nga tremujori i kaluar, kërkesa për kredi me qëllim *financimin e banesës* rezultoi në rënie. Balanca përkatëse rezultoi -10% nga +1.2% që ishte në tremujorin e mëparshëm.

Grafik 9. Kërkesa e individëve për kredi totale (*balanca neto)*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Faktorët kryesorë që nxitën kërkesën e individëve për kredi vijojnë të jenë *kushtet e kreditimit* të aplikuara nga banka, nevoja e familjarëve për të *financuar konsumin* dhe *banesën, zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme*, si dhe *vendimet e Bankës së Shqipërisë.*

Grafik 10. Faktorët ndikues në kërkesën për kredi të individëve *(balanca neto)*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Aktiviteti kreditues sipas monedhës

Për tremujorin e katërt vitit 2014, aktiviteti kreditues në Lek pritet të rritet ndjeshëm dhe ai në valutë të bjerë pak. Ekspertët e bankave presin që rënia e normave të interesit të vijojë në tremujorin e katërt, si për kredinë në Lek, ashtu edhe për atë në valutë.

Grafik 11. Pritjet e bankave për aktivitetin kreditues (majtas) dhe për normat e interesit (djathtas), pas një tremujori *(balanca neto*, përqindje neto e bankave që presin rritje të treguesit)*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

** Balanca pozitive tregon rritje të aktivitetit kreditues ose rritje të normës së interesit, ndërsa balanca negative tregon ulje të aktivitetit kreditues ose ulje të normës së interesit.*

Ecuria e raportit të kredive të aprovuara ndaj atyre të kërkuara në total shënoi rritje në krahasim me tremujorin e kaluar. Në ndarjen sipas llojit të klientit, raporti i kredive të aprovuara është më i lartë për bizneset krahasuar me individët, dhe për kreditë në Lek krahasuar me ato në valutë.

Aneks 1. Kredia për biznese

Në procesin e agregimit të rezultateve, secili opinion është peshuar në bazë të përgjigjes së tij. Për shembull, bankave që janë përgjigjur se standardet janë "shtrënguar shumë" u është dhënë dyfishi i peshës, krahasuar me përgjigjet "shtrënguar pak". Rezultatet analizohen duke llogaritur balancën neto si diferencën e përgjigjeve të peshuara të bankave që kanë raportuar lehtësim/rritje të standardeve/kërkesës dhe atyre që kanë raportuar shtrëngim/ulje të standardeve/kërkesës. Balancat neto janë shkallëzuar në mënyrë që të marrin vlera brenda intervalit +/- 100.

BIZNESE	**T2 '13**	**T3 '13**	**T4 '13**	**T1 '14**	**T2 '14**	**T3 '14**
Si kanë ndryshuar standardet e miratimit të kredisë?						
- Tremujorin aktual	-2.3%	0.0%	-5.1%	-7.4%	12.1%	0.0%
- Tremujorin e ardhshëm	3.2%	-0.3%	3.1%	4.4%	2.8%	0.7%
Faktorët që kanë ndikuar standardet e miratimit të kredisë:						
-Mjaftueshmëria e kapitalit të bankës	0.0%	5.7%	2.1%	6.3%	-11.4%	2.1%
-Vendimet e Bankës së Shqipërisë	14.4%	16.6%	16.1%	30.4%	38.5%	30.4%
-Konkurrenca në sistemin bankar	0.0%	7.4%	1.8%	-3.4%	6.5%	27.1%
-Niveli aktual ose i pritshëm i likuiditetit	8.3%	8.7%	-5.9%	11.2%	18.5%	11.2%
-Problemet specifike të sektorit ku vepron biznesi	-54.9%	-36.1%	-57.5%	-51.8%	-54.4%	-42.6%
-Situata aktuale ose e pritshme makroekonomike	-41.7%	-22.9%	-42.6%	-37.4%	-22.6%	-9.1%
-Kreditë me probleme	-52.6%	-32.3%	-49.3%	-47.7%	-55.1%	-34.6%
Si kanë ndryshuar kushtet e miratimit të kredisë?						
-Marzhi mesatar	1.3%	19.3%	10.2%	8.6%	19.8%	22.3%
-Marzhi për kreditë me rrezik	-43.9%	-19.4%	-36.5%	-21.8%	-8.9%	-5.1%
-Komisionet	-5.7%	11.4%	18.9%	18.9%	12.7%	6.3%
-Madhësia e kredisë	5.7%	-5.7%	-0.3%	2.0%	2.0%	-1.8%
-Kërkesa për kolateral/në raport me madhësinë e kredisë	-11.4%	0.7%	-15.2%	-6.3%	7.6%	9.4%
-Maturiteti maksimal i kredisë	-2.3%	3.3%	6.3%	5.8%	3.4%	3.4%
Si ka ndryshuar kërkesa e bizneseve për kredi?						
-SME tremujorin e kaluar	9.5%	-15.6%	-10.3%	-8.1%	19.8%	-3.1%
-SME tremujorin e ardhshëm	-0.9%	23.4%	-0.4%	31.8%	9.0%	18.6%
-Korporata tremujorin e kaluar	-17.3%	-21.8%	-32.5%	-9.2%	3.7%	4.3%
-Korporata tremujorin e ardhshëm	-3.2%	26.9%	-10.8%	19.8%	2.8%	4.3%
Faktorët që kanë ndikuar ndryshimin e kërkesës për kredi:						
-Nevoja për financimin e inventarëve	15.6%	19.9%	24.9%	5.9%	36.3%	30.5%
-Nevoja për financimin e investimeve fikse	-7.4%	-12.2%	18.7%	-25.9%	11.4%	7.3%
-Përdorimi i burimeve alternative të financimit	-35.9%	-7.6%	4.2%	-15.1%	-4.4%	4.6%
-Vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë	13.5%	8.0%	5.2%	31.1%	5.0%	10.5%
-Kushtet e kreditimit të aplikuara nga banka juaj	6.4%	10.3%	-16.1%	8.0%	9.2%	36.9%
-Situata aktuale ose e pritshme makroekonomike	-29.1%	-56.0%	7.2%	-38.3%	4.6%	17.8%

Aneks 2. Kredia për individë

Në procesin e agregimit të rezultateve, secili opinion është peshuar në bazë të përgjigjes së tij. Për shembull, bankave që janë përgjigjur se standardet janë "shtrënguar shumë" u është dhënë dyfishi i peshës, krahasuar me përgjigjet "shtrënguar pak". Rezultatet analizohen duke llogaritur balancën neto si diferencën e përgjigjeve të peshuara të bankave, që kanë raportuar lehtësim/rritje të standardeve/kërkesës dhe atyre që kanë raportuar shtrëngim/rënie të procedurave/kërkesës. Balancat neto janë shkallëzuar në mënyrë që të marrin vlera brenda intervalit +/- 100.

INDIVIDË	**T2 '13**	**T3 '13**	**T4 '13**	**T1 '14**	**T2 '14**	**T3 '14**
Si kanë ndryshuar standardet e miratimit të kredisë?						
- Tremujorin e kaluar	3.7%	-0.4%	10.8%	3.1%	16.9%	18.2%
- Tremujorin e ardhshëm	6.8%	9.9%	8.4%	25.8%	29.6%	0.0%
Faktorët që kanë ndikuar standardet e miratimit të kredisë:						
-Mjaftueshmëria e kapitalit të bankës	9.9%	9.9%	3.4%	9.5%	-3.6%	-3.4%
-Vendimet e Bankës së Shqipërisë	6.3%	2.3%	-6.5%	6.1%	16.8%	20.1%
-Konkurrenca e sistemit bankar	23.0%	10.3%	11.1%	12.6%	15.8%	22.6%
-Niveli aktual ose i pritshëm i likuiditetit	19.3%	17.0%	7.7%	17.2%	4.7%	10.4%
-Gjendja financiare e individëve	-21.4%	-24.6%	-24.1%	-15.4%	-24.0%	-4.9%
-Kreditë me probleme	-21.0%	-25.9%	-29.6%	-27.0%	-19.7%	-6.3%
-Zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme	-8.1%	-9.1%	-9.7%	-14.5%	9.8%	7.3%
Si kanë ndryshuar kushtet e miratimit të kredisë?						
-Marzhi mesatar	13.2%	-0.4%	5.6%	14.2%	17.7%	29.6%
-Marzhi për kreditë me rrezik	-4.1%	-4.1%	-6.2%	-4.3%	-7.5%	7.7%
-Komisionet	14.8%	3.7%	7.7%	2.0%	9.4%	5.3%
-Madhësia e kredisë	0.0%	-3.3%	0.0%	5.2%	4.7%	19.1%
-Kërkesa për kolateral/në raport me madhësinë e kredisë	7.3%	7.3%	4.6%	-0.9%	-5.9%	-2.1%
-Maturiteti maksimal i kredisë	13.1%	5.0%	16.4%	3.1%	15.4%	7.4%
-Raporti këst/të ardhura	6.3%	0.0%	-4.3%	6.1%	6.5%	11.4%
Si ka ndryshuar kërkesa e individëve për kredi?						
-Kredi për shtëpi	6.9%	-11.7%	-2.2%	-8.7%	1.2%	-10%
-Kredi për konsum	23.0%	7.6%	9.5%	9.8%	19.3%	31.2%
Faktorët që kanë ndikuar ndryshimin e kërkesës për kredi:						
-Nevoja e individëve për financimin e blerjes së shtëpisë	43.7%	18.1%	24.9%	13.4%	20.5%	4.2%
-Nevoja e individëve për financimin e konsumit	28.6%	7.3%	18.7%	29.4%	28.8%	43.2%
-Përdorimi i burimeve alternative të financimit	-8.7%	-10.5%	4.2%	0.9%	2.6%	5.9%
-Vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë	14.9%	14.0%	5.2%	14.7%	23.3%	25.3%
-Besimi i konsumatorëve	7.5%	-17.3%	-16.1%	-5.1%	1.3%	4.4%
-Zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme	21.6%	4.4%	7.2%	6.4%	23.7%	22.8%
-Kushtet e kreditimit të aplikuara nga banka juaj	37.4%	23.3%	17.9%	26.2%	29.4%	43.0%